



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

DREJTORIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

Prizren, 27.01.2025

THIRRJE PUBLIKE

Për anëtarë të komisionit për vlerësimin e projekt propozimeve të OJQ-ve për Drejtorin e Kulturës, Rinis dhe Sportit.

Bazuar në Rregulloren e Ministrisë së Financave Nr.: 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat financimit publik të OJQ-ve në Nenin 8, paragrafin 3.2 që pjesë e çdo Komisioni Vlerësues për vlerësimin e projekt propozimeve të OJQ-ve të pranuar sipas thirrjes publike duhen të jetë një përfaqësues nga grupi i ekspertëve të jashtëm, duke përfshirë një përfaqësues të OJQ-ve.

Për këtë qëllim DKRS-ja fton të gjithë të interesuarit që të aplikojnë për të qenë pjesë në cilësinë e anëtarit të Komisioni Vlerësues për të vlerësuar projekt propozimet e dorëzuara nga OJQ-të.

Të gjithë kandidatët të cilët nuk janë nën hetime apo me procedurë penale dhe që kanë përvojë në shoqëri civile me përparësi nga OJQ-të që merren me fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit mund të aplikojnë për pjesëmarrje në Komisionin Vlerësues në cilësi të :

1. Një përfaqësues nga OJQ-të ;
2. Një përfaqësues në cilësinë e ekspertit.

Të drejtë aplikimi kanë :

- Të angazhuar në Organizatat jo-qeveritare aktive që veprojnë në Komunën e Prizrenit ;
- Ekspert të pavarur të cilët kanë përvojë pune që ndërlihet me hartimin dhe menaxhimin e projekteve në fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kushte :

- Duhet të kenë të diplomë universitare ;
- Të ketë përvojë në hartimin dhe menaxhimin e projektetve të OJQ-ve kulturore, rinore dhe sportive;
- Të mos jenë të emëruar politik, shërbyes civil apo pozita të ngjashme në administratën shtetërore.

Kandidatët duhet të dorëzojnë këto dokumente :

- Një CV ;
- Përfaqësuesi nga OJQ-të duhet të dorëzoj një letër nominimi nga udhëheqësi i OJQ-së në të cilën dëshmohet se aplikuesi është i punësuar apo i angazhuar në organizatë
- Përfaqësues në cilësinë e ekspertit duhet të kenë diplomë universitare .

Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen, në adresën e mëposhtme:

Komuna e Prizrenit
Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Sporteli nr.:1- 5në ndërtesën e Komunës,
20000 Prizren

Afati i apikimit nga data 27.01.2025 deri më datën 07.02.2025

Komisioni i themeluar nga DKRS-ja do t'i vlerësoj të gjitha aplikacionet e pranuar dhe kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e përcaktuara përmes kësaj ftese publike do të jenë pjesë e Komisionit Vlerësues për subvencionimin e Ojq-ve për vitin 2025.

V.v.



Me respekt,
Drejtori i KRS-së
Adem Morina